

Tiranë, më \_\_. \_\_. 2023

**Formulari Nr.3**

**Autoriteti Kontraktor  
ALBCONTROL SHA**

**FTESA PËR OFERTË**

Autoriteti Kontraktor ALBCONTROL SHA do të zhvillojë procedurën e prokurimit për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar nr. 2594/1 Prot. me objekt: “Blerje bilete të transportit ajror ndërkombëtar, me destinacion Madrid dhe Luksemburg”.

Data e zhvillimit do të jetë 01.12.2023, ora 12:50 në adresën [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al).

Jeni të lutur të paraqisni ofertën tuaj për këtë objekt prokurimi me këto të dhëna:

1. Biletë Tiranë – Madrid – Tiranë, nisja më datë 03.12.2023 dhe kthimi më datë 05.12.2023, për 2 (dy) persona.
  2. Biletë Tiranë – Luksemburg – Tiranë, nisja më datë 03.12.2023 dhe kthimi më datë 09.12.2023, për 1 (një) person.
- Operatori ekonomik i renditur i pari, përpara se të shpallet fitues, duhet të dorëzojë, dokumentat sipas **shtojcës nr. 1, ku gjeni dhe detajet e itinerareve të fluturimit:**

## **Shtojca nr. 1**

Operatori ekonomik i renditur i pari, përpara se të shpallet fitues, duhet të dorëzojë, dokumentat si më poshtë:

- a) Rezervimin e biletës, sipas destinacionit të kërkuar me itinerare të detajuara, duke përfshirë klasin, sasinë, statusin dhe të dhëna të tjera alfanumerike që kanë të bëjnë me segmentet e udhëtimit si dhe kodin e llogarisë së klientit.

*Në rast anullimesh apo vonesash nga kompanitë ajrore të fluturimit, Operatori Ekonomik do të bashkëpunojë me Autoritetin Kontraktor për riorganizimin e Itinerarit.*

- Shpenzimet e transportit përfshijnë udhëtimin me avion me destinacion Madrid dhe Luksemburg, sipas itinerarit si mëposhtë:

- a. Itinerari (1): **Tiranë – Madrid – Tiranë, për 2 (dy) persona, si mëposhtë:**

- **Nisja** nga Tirana për 2 persona, më datë **03.12.2023**, të bëhet jo më herët se ora 14:00 PM, të ketë jo më shumë se një tranzit dhe mbërritja në Madrid jo më vonë se ora 22:00 PM.
- **Kthimi** nga Madrid më datë **05.12.2023**, të bëhet jo më herët se ora 13:00 PM, të ketë jo më shumë se një tranzit dhe mbërritja në Tiranë jo më vonë se ora 23:00 PM.

- b. Itinerari (2): **Tiranë – Luksemburg – Tiranë, për 1 (një) person, si mëposhtë:**

- **Nisja** nga Tirana për 1 person, më datë **03.12.2023**, të bëhet jo më herët se ora 06:00 AM, të ketë jo më shumë se një tranzit dhe mbërritja në Luksemburg jo më vonë se ora 14:00 PM.
- **Kthimi** nga Luksemburg më datë **09.12.2023**, të bëhet jo më herët se ora 17:00 PM, të ketë jo më shumë se një tranzit.

- *Sqarim: Në rastet e fluturimeve me tranzit, preferohet që koha tranzite të jetë mbi 45 min., për shkak të procedurave dhe vonesave të ndryshme që mund të krijohen në nyjet e kontrollit që ushtrohen në aeroporte.*

- Minimalisht 1 (një) bagazh dore dhe 1 (një) valixhe bagazh max deri në 20 kg (on board, hand luggage dhe check-in baggage)/për person në vajtje dhe ardhje i përfshirë.

- Klasi ekonomik.

- b) Dokumenta të tjera:

- Operatori ekonomik të paraqesë Ekstraktin e QKB-së, ku aktiviteti tregtar të jetë objekt i kësaj procedure si dhe statusi të jetë aktiv.
- Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë që është i pajisur me certifikatë akreditimi/marrëveshje lëshuar nga/me International Air Transport Association (I.A.T.A.), të vlefshme për vitin 2023 dhe valideti të jetë i verifikueshëm online.
- Në ofertën e tij, ofertuesi duhet të paraqesë të dhënat e plota të kontaktit.

- Në zbatim të pikës 12 të Udhëzimit të APP-së nr. 03, datë 18.06.2021 “Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar dhe zhvillimin me mjete elektronike”, të ndryshuar, konkretisht: “Me marrjen e njoftimit, ofertuesi duhet t’i përgjigjet autoritetit kontraktor brenda një afati të përcaktuar nga ky i fundit në ftesën për ofertë. Ky afat duhet të jetë minimalisht 2 (dy) orë nga momenti i njoftimit të këtij operatori nga komisioni i Sistemit Dinamik të Biletave”.
- Afati i dorëzimit të dokumentave në sistemin e prokurimit elektronik sipas Ftesës për Ofertë, do të jetë brenda **2 orëve** nga momenti i publikimit të njoftimit të fituesit.

**Shënim:** Autoriteti Kontraktor në zbatim të ligjit Nr. 87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, i ndryshuar, do pranojë të likujdojë vetëm fatura elektronike për shërbimin e marrë.

- \* Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, apo mosdorëzimi i biletave të udhëtimit sipas termave të referencës dhe grafikut të itinerarit, konsiderohen si kushte për skualifikim.
- \* Në rast të pamundësisë së realizimit të objektit të prokurimit, jeni të lutur të njoftoni në sistemin elektronik të app-së brenda afatit të përcaktuar në Ftesën për Ofertë nga shpallja e njoftimit të fituesit.

## **TITULLAR I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Laureta Omeri**